



Financuar nga
Bashkimi Evropian



SKILLED WORKFORCE FOR ECONOMIC INTEGRATION

SHQYRTIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE TË PUNËSIMIT NË SHQIPËRI DHE KOSOVË

Raport Hulumtues





Financuar nga
Bashkimi Evropian



SHQYRTIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE TË PUNËSIMIT NË SHQIPËRI DHE KOSOVË

Raport Hulumtues

Raport i hulumtimit për shqyrtimin e shërbimeve publike të punësimit në Shqipëri dhe Kosovë

Konsulentët e angazhuar në hulumtim:

Bujar Gallopeni në Kosovë

Manjloa Duli në Shqipëri

Prishtinë, Dhjetor 2019



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit “Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik - SWEI” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i cili implementohet nga APPK-Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë dhe ISI - Instituti për Studime Ndërkombëtare në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	2
1. Lista e shkurtesave.....	3
2. Hyrje.....	4
3. Metodologjia.....	7
4. Shërbimet Publike të Punësimit në Republikën e Kosovës.....	9
4.1 Korniza ligjore dhe e politikave.....	9
Sistemi Kombëtar i Shërbimeve Publike të Punësimit në Republikën e Kosovës	10
4.2 Masat aktive të tregut të punës.....	13
4.3 Arsimi dhe Aftësimi profesional në Kosovë.....	17
4.4 Zhvillimi i standardeve profesionale dhe kurrikulave në AAP në Republikën e Kosovës.....	18
5. Shërbimet Publike të Punësimit në Republikën e Shqipërisë.....	21
5.1 Korniza ligjore dhe Korniza e politikave.....	23
5.2 Masat aktive të punësimit	31
5.2 Zhvillimi i standardeve profesionale dhe kurrikulave në arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë	35
6. Konkluzionet dhe Praktikat e mira.....	37
7. Rekomandimet.....	39
8. Bibliografia	41

1. LISTA E SHKURTESAVE

AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
APPK	Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
ISI	Instituti për Studime Ndërkombëtare
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
KKKP	Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
QAP	Qendra e Arsimit Profesional
QMF	Qendra Multifunkionale
SWEI	Projekti: Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik / <i>Skilled Workforce for Economic Integration</i>
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave

2. HYRJE

Ky raport analizon situatën e tregut të punës në Kosovë dhe Shqipëri duke u ndalur jo vetëm në përshkrimin statistikor të treguesve të këtij tregu, por përpiqet të japë një panoramë të përgjithshme të politikave, instrumenteve ligjor që zbatohen në të dy vendet Kosovë dhe Shqipëri, duke treguar veçoritë dhe të përbashkëtat që ekzistojnë në sistemin e tregut të punës ndërmjet dy vendeve.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij raporti bëhet e mundur analiza krahasuese e skemave të punësimit si një mënyrë për të parë pozicionimin e Shqipërisë dhe Kosovës përsa u përket treguesve të këtij tregu dhe për të parë pikat e forta dhe të dobëta që ka tregu i punës në të dy vendet, sidomos për punësimin e qëndrueshëm të të rinjve.

Raporti përfundon me disa nga gjetjet kryesore të situatës aktuale si dhe disa rekomandime të mbështetura mbi analiza të detajuara duke synuar një orientim më të mirë për politikë-bërësit në Kosove dhe Shqipëri.

Punësimi i qëndrueshëm është sfidë e vazhdueshme për Kosovën, Shqipërinë, por edhe për rajonin në përgjithësi. Punësimi dhe zhvillimi i tregut të punës në njërin anë varet edhe nga zhvillimi ekonomik i vendeve dhe qëndrueshmëria e ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe në anën tjetër kemi të bëjmë me zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe fuqisë punëtore me njohuritë dhe shkathtësitë bashkëkohore, duke plotësuar kërkesat e tregut të punës, e cila po ashtu është sfidë mjaft prezentë në sistemet e edukimit dhe trajnimit të të dyja vendeve.

Në lehtësimin e punësimit të të rinjve dhe ofrimin e mundësive ndërmjetësuese në këtë proces, të dyja vendet, Kosova dhe Shqipëria, kanë themeluar dhe funksionalizuar mekanizmat relevant shtetërorë, respektivisht shërbimet publike të punësimit, të cilat janë të mandatuar të ofrojnë shërbime të rregullta për qytetarët e vendeve respektive. Këto shërbime publike operojnë në nivelet qendrore, rajonale dhe lokale, me qëllim që të jenë më afër qytetarëve me shërbimet e tyre.

Shërbimet publike të punësimit në Kosovë dhe Shqipëri kryesisht operojnë brenda kufijve të të dyja vendeve duke ofruar shërbimet e tyre për qytetarët e vendeve respektive. Të dyja vendet deri tani kanë marrë hapa të kufizuar dhe jo të qëndrueshme për të ofruar shërbime edhe për qytetarët përtej kufijve, këto forma bashkëpunimi janë materializuar në marrëveshje respektive

midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj të Kosovës¹, me qëllim krijimin e mundësive për një integrimin ekonomik të zonave ndërkufitare.

Prandaj, është esenciale të eksploroheh mundësitë ligjore dhe praktikatat potenciale nga të dyja vendet në mënyrë që të mund të shfrytëzohet potenciali dhe të stimulohen iniciativat e reja për krijim të kushteve dhe masave për lëvizje të fuqisë punëtore ndërkufitare, si dhe ndërmarrjen e iniciativave të përbashkëta në nivel shtetëror dhe rajonal që përkrahin këto iniciativa reciproke.

Duke adresuar disa nga sfidat e punësimit të të rinjve në Kosovë dhe Shqipëri, në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë nga Bashkimi Evropian është mbështetur projekti **“Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik (*Skilled workforce for Economic Integration – SWEI*)”**, i cili implementohet nga Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë (APPK) dhe Instituti për Studime Ndërkombëtare (ISI) në Shqipëri, në bashkëpunim me autoritetet respektive të shërbimeve të punësimit të të dyja vendeve.

Projekti SWEI është dizajnuar me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave, përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së Shërbimeve të Punësimit të Qendrave të Aftësisimit Profesional për punësim të qëndrueshëm të punëkërkuësve, trajnimin e të rinjve për të mbështetur integrimin socio-ekonomik në rajonin ndërkufitar Kosovë-Shqipëri.

Më tutje, projekti ka për qëllim që të stimulojë praktikat e reja për punësimin e të rinjve në sektorët specifik ekonomik, duke ndihmuar autoritetet dhe mekanizmat respektiv që të eksplorojnë dhe ndërmarrin iniciativat të përbashkëta në lëvizje të fuqisë punëtore. Po ashtu projekti synon të zhvillojë standarde profesionale dhe programe të reja trajnimi për shkathtësi të reja punësimi, si dhe të trajtojë një numër të konsiderueshëm të të rinjve në profesione të caktuara. Një nga aktivitetet bazë të projektit është hartimi i një raporti vlerësues të shërbimeve publike të punësimit duke pasqyruar sistemet e shërbimeve të punësimit në Kosovë dhe Shqipëri, format e rregullimit dhe operimit të tyre, shërbimet që ofrohen, praktikatat e suksesshme, sfidat dhe rekomandimet për avancim të praktikave relevante të shërbimeve të punësimit.

Prandaj, qëllimi i këtij raporti vlerësues është që të ofrojë një informacion të përmbledhur dhe konciz për grupet e interesit, respektivisht autoritetet qeveritare, zyrtarët rajonale të punësimit, dhe aktorët e tjerë, në mënyrë që të reflektojnë në hapat e mëtejshëm dhe iniciativat e përbashkëta ndërmjet të dyja vendeve me qëllim të integritimit të përbashkët ekonomik të

¹ Marrëveshje Bashkëpunimi në fushën e punësimit dhe ofrimit të aftësive profesionale datë 06.03.2015

zonave ndërkufitar Kosovë-Shqipëri dhe rritjes së mundësive të punësimit për të rinjtë e këtyre zonave.

Raporti në vijim paraqet metodologjinë dhe hapat që janë ndërmarrë për të mbledhur dhe shqyrtuar të dhëna për vlerësim të këtij sektori. Më tutje, raporti jep një përshkrimin në detaje të sistemeve kombëtare të shërbimeve publike të punësimit, përfshirë kornizën ligjore dhe strategjike, masat aktive të tregut të punës, etj.

Gjithashtu, raporti fokusohet në nxjerrjen e praktikave dhe përvojave të mira, si dhe një listë të rekomandimeve për iniciativa të reja në secilin vend veç e veç apo të iniciativave të përbashkëta ndërmjet të dy vendeve për të përmirësuar më tutje ofrimin e shërbimeve adekuate të punësimit.

3. METODOLOGJIA

Në hartimin e raportit të vlerësimit të shërbimeve publike të punësimit në Kosovë dhe Shqipëri janë angazhuar nga projekti dy ekspertë të jashtëm, njëri për Kosovë dhe tjetri për Shqipëri.

Ekspertët kanë shfrytëzuar të dhëna nga dokumente të ndryshme, respektivisht është shqyrtuar korniza ligjore dhe e politikave të të dy vendeve.

Raporti mbështetet:

a) në të dhënat parësore të institucioneve kosovare dhe shqiptare dhe në mënyrë të veçantë në të dhënat e Institutit të Statistikave (INSTAT), Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Shqipëri, Agjencia e Punësimit së Kosovës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit Tirane, Zyra e punës Lezhë, Qendra e Aftësimit Profesional Prizren.

b) burime sekondare, të dhëna të marra nga studime të ndryshme të bëra nga universitetet shqiptare, anketime me protokolle të përcaktuara për objekte ose procese të tregut të punës, dhe studime individuale të bëra nga hulumtues të veçantë.

Arsyeja e përdorimit të të gjithë burimeve zyrtare të të dhënave është bërë për shkak të diferencave që kanë burime të ndryshme dhe në të njëjtën kohë edhe për faktin e frekuencave të ndryshme kohore që i referohen.

Është i rëndësishëm që të theksohet fakti që në vlerësimin e treguesve të tregut të punës në Shqipëri përdoren dy burime të ndryshme informacioni; burimi i parë i referohet të dhënave të mbledhura nëpërmjet Anketës së Forcave të Punës (AFP), INSTAT e cila ka nxjerrë rezultatet e para në vitin 2007 me frekuencë vjetore, dhe nga viti 2012 edhe me frekuencë tremujore dhe burimi i dytë janë të dhënat administrative të cilat janë të disponueshme që nga viti 2000, si dhe të dhënat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit², Strategjisë kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020³

Shqyrtimi i kornizë ligjore dhe politikave strategjike ka ndihmuar të nxjerrim një pasqyrë të strukturës së organizimit të shërbimeve publike të punësimit në të dy vendet, si dhe të identifikojmë dhe të listojmë prioritetet kryesore strategjike të sektorit të punësimit, masat aktive të tregut të punës, si dhe masat dhe aktivitete që do të ndërmerren në vitet në vijim, dhe implikimet e ndryshme në zbatimin e tyre.

Hartimit të këtij raporti i ka kontribuar edhe vizita e ekipi të projektit dhe hartuesve të këtij raporti tek autoritetet qendrore dhe rajonale të shërbimeve të punësimit në Kosovë dhe

² <http://www.shkp.gov.al>

³ http://financa.gov.al/wpcontent/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimit.pdf

Shqipëri, duke marr informacion drejtpërdrejtë nga udhëheqësit e autoriteteve respektive. Me konkretisht, ekipi i projektit ka vizituar Agjencinë e Punësimit në Kosovë, Qendrën e Aftësisimit Profesional dhe Zyrën e Punësimit në Prizren, si dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit të Shqipërisë, dhe Shërbimin Rajonal të Punësimit në Lezhë

4. SHËRBIMET PUBLIKE TË PUNËSIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

4.1 Korniza ligjore dhe e politikave

Politikat e shërbimeve publike të punësimit dhe masat aktive të tregut të punës në Republikën e Kosovës janë të rregulluar me Ligjin nr.5 /L-077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të papunët, Punëkërkuesit dhe Punëdhënësit, si dhe paraprakisht me Ligjin nr. 04 / L-083 për Regjistrimin dhe Evidencën e Papunësuarve dhe Punëkërkuesve. Gjithashtu, rregullimi, funksionalizimi dhe fushëveprimi i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës është i rregulluar përmes Ligjit nr. 04 / L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Në zbatim të këtyre ligjeve poashtu është e zhvilluar një numër i caktuar i legjislacionit sekondar (udhëzimeve administrative dhe rregulloreve), një prej të cilave është edhe Rregullorja (nr. 01 / 2018) për Masat Aktive të Tregut të Punës.

Për më tepër, Strategjia Sektoriale 2018-2022 e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale vendos caqet strategjike afatmesme të shërbimeve të punësimit. Dy nga katër objektivat e strategjisë janë dedikuar për zbutjen e papunësisë dhe shkallës së inaktivitetit:

Objektivi strategjik 1: Ulja e inaktivitetit, rritja e punësimit, zhvillimi i shkathtësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe administrimi më i mirë i tregut të punës.

Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i kushteve të punës dhe zvogëlimi i punësimit informal përmes fuqizimit të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe forcimit të dialogut social.

Përmes arritjes së këtyre objektivave dhe aktiviteteve relevante synohet të adresohen disa sfida të cilat kanë të bëjnë me rritjen e numrit të të papunëve si përfitues të shërbimeve publike të punësimit, posaçërisht grave dhe të rinjve, rritjen e mekanizmave dhe shërbimeve për orientim dhe këshillim në karrierë, përcaktimin e kornizës së monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të MATP-ve, rritja e konsiderueshme e bashkëpunimit ndërmjet zyrave të punësimit dhe QAP-ve me bizneset, rritja e numrit të programeve profesionale sipas nevojave të tregut të punës, etj.

Sfidë tjetër kryesore e adresuar në zbatimin e MATP-ve është mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për adresuar përkrahjen e të gjitha kërkesave që vijnë nga vlerësimet e zyrave të punësimit. Edhe pse për tri vite të strategjisë sektoriale 2018-2022 janë alokuar mbi 16 milion Euro për të përkrahur objektivat e mbështetjes së masave të punësimit, rreth 40% e këtij buxheti parashihen të mbulohen nga donatorë të mundshëm. Një situatë e tillë nuk siguron një qëndrueshmëri financiare për të zbatuar si duhet MATP-të.

Sistemi Kombëtar i Shërbimeve Publike të Punësimit në Republikën e Kosovës

Për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe avancimin e tyre brenda kornizës ligjore aktuale është definuar një lloj Sistemi Kombëtar i Shërbimeve Publike të Punësimit (shih figurën nr. 1). Në nivelin qendror, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është përgjegjëse për hartimin e politikave ligjore dhe strategjike të punësimit, dhe monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Derisa, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) ka mandat në zbatimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit drejtpërdrejtë tek qytetarët e Kosovës.




Figura 1. Struktura Qeverisëse dhe rregullative e shërbimeve publike të punësimit në Republikën e Kosovës

Shërbimet e punësimit ofrohen nga APRK për dy kategori kryesore:

Punëdhënësit

Nga zyrat e punësimit punëdhënësve u ofrohen shërbime të regjistrimit në platformën online të punësimit (apr.k.rks.gov.net), duke u mundësuar të shpallin vendet e lira të punës drejtpërdrejtë në platformë, pastaj u ofrohen profile të ndryshme të punëkërkesve, si dhe marrin përkrahje në faza të ndryshme të seleksionimit të kandidatëve për pozitat e punës që ofrojnë. Këto shërbime kanë mundësuar që interesi i punëdhënësve të jetë më i lartë dhe të shfrytëzojnë platformën online për regjistrim të kërkesave të tyre. Me këtë rast, me kalimin e kohës, platforma shfrytëzohet shumë e më shumë nga bizneset dhe punëdhënësit tjerë, duke rritur numrin e vendeve të punës në platformë vazhdimisht (shih fig. nr. 2).




Figura nr. 2. Vendet e lira të punës të regjistruar nga punëdhënësit në platformën online

Burimi: MPMS: Sistemi Informatave mbi Tregun e Punës

Njëkohësisht, duke pasur një interesim më të madh të punëdhënësve, edhe aktiviteti i zyrave të punësimit në ofrim të ndërmjetësimit në punësim është në rritje çdo vit e më shumë. Ndërmjetësimi realizohet përmes ndërmjetësimeve të rregullta, ku bëhet seleksionimi sipas profilit të punëkërkesit të regjistruar dhe pozitës së shpallur nga punëdhënësi, apo përmes MATP-ve (subvencionimit të pagës, punës praktike, etj). Forma parë e ndërmjetësimit, pra ndërmjetësimi i rregullt, duket të kontribuojë më shumë në punësim (shih figurën nr. 3).




Figura nr. 3. Punësimet sipas formave të ndërmjetësimi për 2015-2018

Burimi: MPMS: Sistemi Informatave mbi Tregun e Punës

Punëkërkuësit

Të gjithë personat e papunë të regjistruara pranë zyrave të punësimit MPMS⁴ i kategorizon në dy grupe kryesore:

- **Punëkërkuësit e regjistruar** – punëkërkuësit e regjistruar në platformën online dhe janë përdorues vetëm të shërbimeve të punësimit të ofruara përmes internetit.
- **Të papunësuarit e regjistruar** - të papunësuarit që vizitojnë zyrat e punësimit për të kërkuar punë dhe për të marrë shërbime në këto zyre.

Të papunësuarit që regjistrohen dhe marrin shërbimet tek zyrat e punësimit, kategorizohen në njërin nga tri grupet në vijim, të cilëve edhe u ofrohen shërbime relevante:

- Grupi me rrezik të ulët për t'u bërë i papunë afatgjatë
- Grupi me rrezik të mesëm për t'u bërë i papunë afatgjatë
- Grupi me rrezik të lartë për t'u bërë i papunë afatgjatë

Për punëkërkuësit, shërbimet e punësimit ofrohen përmes masave aktive të tregut të punës, të cilat janë të prezantuara gjerësisht në vijim.

⁴ MPMS, Raporti: Puna dhe Punësimi 2016

4.2 Masat aktive të tregut të punës

Nga sfidat kryesore dhe afatgjatë të shoqërisë kosovare është akoma shkalla e lartë e papunësisë, e cila viteve të fundit llogaritet të jetë rreth 27.5% (MPMS, 2017), nga të cilët 56% janë femra, derisa për të rinjtë rreth 52.4% (Ibid, 15). Për të ndihmuar zbutjen e papunësisë në formë të vazhdueshme MPMS ka prezantuar një sërë Masash Aktive të Tregut të Punës (MATP) të listuara në kuadër të shërbimeve publike të punësimit. MATP janë të ofruara nga APRK në nivelin e Zyrave për Punësim, të cilat janë të sistematizuara në nivel komunal (në 33 komuna), dhe Qendrave të Aftësisimit Profesional, të lokalizuara në nivel të rajoneve (në 8 rajone), shih figurën nr. 4.



Figura nr. 4. Shpërndarja e Zyrave të Punësimit, dhe Qendrave të Arsimit Profesional në tërë Republikën e Kosovës.

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

APRK, bazuar në Ligjin nr. 04 / L-205, dhe Rregulloren nr. 01 / 2018, është e mandatuar për definimin dhe azhurnimin e MATP-ve, si dhe zbatimin e tyre në terren. Në rregulloren e lartpërmendur janë të listuara këto MATP, të cilat aktualisht janë duke u ofruar për qytetarët e Republikës së Kosovës, (shih tabelën nr. 1).

MATP	Shpjegim
Subvencionimi i pagës	Përfituesit janë të papunësuarit e regjistruar (sidomos të papunët afatgjatë), ku iu ofrohet një punësim i rregullt minimum 12 muaj, me mundësi vazhdimi. Subvencionimi i pagës bëhet në vlerën 50%, të pagës minimale të përcaktuar në Kosovë.
Trajnimi në punë	Ofrohet në Qendrat e Aftësimi Profesional (QAP) për të papunësuarit e regjistruar (me prioritet për të papunët afatgjatë), në kohëzgjatje ndërmjet 2-6 muaj, duke përcaktuar paraprakisht një plan individual të trajnimit në fushën e interesit të përfituesit. Gjatë periudhës së ndjekjes së trajnimit, përfituesi kompensohet deri në vlerën prej 70% të pagës minimale të përcaktuar në Kosovë, për mbulimin e shpenzimeve të ndjekjes së trajnimit.
Aftësimi profesional	Ofrohet falas për të papunësuarit dhe punëkërkuarit e regjistruar, në kohëzgjatje prej 20 ditë pune e deri në 6 muaj. Aftësimet e tilla realizohen në QAP-të, apo në QAP dhe ndërmarrje në një program të kombinuar, i cili është me interes për përfituesin.
Praktika në punë	Ofrohet për të diplomuarit në arsimin e mesëm të lartë, dhe arsimin e lartë, apo ndjekësit e programeve të trajnimit në QAP-të, në kohëzgjatje prej 6 – 12 muaj, me mundësi vazhdimi edhe për një vit. Përfituesi mund të kompensohet në vlerën më së paku të pagës minimale mujore të përcaktuar në Kosovë.
Vetëpunësimi	Ofrohet për të papunësuarit e regjistruar, ku përfituesit përfitojnë nga shërbime falas të trajnimit për shkathtësi bazike të biznesit, zhvillimit të biznes planit, grant financiar (deri në 6 mijë euro) për fillimin e biznesit, si dhe mentorim të mëtutjeshëm në menaxhim të biznesit (deri në 12 muaj pas përfitimit të grantit).
Promovimi i ndërmarrësisë	Ofrohet pa pagesë për të papunësuarit dhe punëkërkuarit e regjistruar. Përfitimi ka të bëjë me ndjekjen e trajnimeve pa pagesë në shkathtësi të avancuara të biznesit, në zhvillim të planit për biznes të qëndrueshëm, grant financiar deri në 10 mijë euro (me 20% bashkë-financim nga përfituesi), dhe mentorim dhe këshillim deri në 6 muaj pas përfitimit të grantit.
Punët publike	Të papunësuarit e regjistruar mund të ofrojnë shërbime publike përmes projekteve (me karakter të përfitimit publik) në kohëzgjatje së paku 2 e deri në 12 muaj. Përfituesit për punën e tyre kompensohen së paku në vlerën e pagës minimale të përcaktuar në Kosovë.
Masat tjera që kanë të bëjnë me tregun e punës	APRK mund të propozojë masa tjera të punësimit, të cilat paraprakisht aprovohen nga MPMS.

Tabela nr. 1. Masat Aktive të Tregut të Punës në Republikën e Kosovës

Burimi: MPMS / Rregullorja nr. 01/2018 për Masat Aktive të Tregut të Punës.

MATP janë duke dhënë gradualisht por me hapa të ngadaltë kontributin e tyre në zbutje të papunësisë në Kosovë. Sipas të dhënave të MPMS (2016), secilin vit ka një ngritje graduale të përfituesve nëpër secilën masë. Masat të cilat kontribuojnë në ngritjen e shkathtësive profesionale kanë arritur të kenë më shumë përfitues (aftësimi profesional, trajnimi në punë, praktikant, etj), por edhe masa që kanë kontribuar direkt në punësim (punët publike dhe subvencionimi i pagës) kanë pasur progres të caktuar ndër vite.




Figura nr. 5. Zbatimi i MATP gjate 2015-2018

Burimi: MPMS: Sistemi Informatave mbi Tregun e Punës

Pjesëmarrja e të regjistruarve të papunë në MATP poashtu varion sipas rajoneve dhe viteve (shih fig. nr. 6). Për shembull në disa komuna ka pasur zvogëlim të pjesëmarrjes në MATP, sikurse është rasti me rajonin e Prishtinës dhe atë të Gjilanit. Ndërsa, në shumicën prej komunave tjera ka pasur një rritje graduale nga 2015 e këndeje në pjesëmarrje në MATP.




Figura nr. 6. Zbatimi i MATP gjate 2015-2018

Burimi: MPMS: Sistemi Informatave mbi Tregun e Punës

4.3 Arsimi dhe Aftësimi profesional në Kosovë

Arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë është një proces me role dhe përgjegjësi ndër-institucionale të institucioneve qeverisëse të nivelit qendror dhe lokal (figura nr. 7).




Figura nr. 7. Sistemi i Arsimit në Kosovë

Burimi: MASHT

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, së bashku me agjencitë respektive që kanë derivuar nga MASHT, (AKK, AKA, AAAPARr) hartojnë dhe zbatojnë politikat e arsimit profesional dhe arsimit për të rritur, si dhe kanë ndërtuar dhe zbatojnë proceset dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë në arsim, zhvillimit të standardeve profesionale, ndërlidhjen me tregut e punës, etj. Aktualisht janë rreth 57 shkolla të arsimit profesional, dhe 5 qendra të kompetencës në Kosovë, të cilat ofrojnë kryesisht arsim formal në nivelet 3, 4 dhe 5 të KKK.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) përmes procesit të akreditimit dhe validimit mbështetë institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional në zhvillim institucional, sigurim të cilësisë, harmonizim dhe validim të kurrikulave dhe programeve me standardet respektive, sipas niveleve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). Ky proces ka ndihmuar në masë të madhe në informim të tregut të punës dhe facilitim të bashkëpunimit me industrinë rreth kualifikimeve të reja dhe avancimit të profileve profesionale sipas kërkesave të tregut.

Në kuadër të aftësimin profesional në Kosovë hyjnë edhe Qendrat Rajonale të Arsimit Profesional (QAP), të cilat administrohen nga APRK. Aktualisht janë tetë (8) QAP në tetë rajonet kryesore, të cilat mbulojnë me shërbimet e tyre të gjitha komunat e Kosovës. QAP ofrojnë dy lloj trajnimesh për të regjistruarit e papunësuar: trajnimi institucional, i cili realizohet në hapësirat e QAP-ve, dhe trajnimet e kombinuara, të cilat realizohen në hapësirat e QAP-ve dhe në kompani të cilat bashkëpunojnë me QAP-at.




Figura nr. 8. Trajnimet certifikuese të realizuara nga QAP-të gjatë periudhës 2015-2017
Burimi: MMPS: Raportet Puna dhe Punësimi 2015-2017

Në shumicën e rajoneve dominon aktiviteti i shtuar i QAP-ve gjatë vitit 2016 në ofrimin e shërbimeve të trajnimit për të regjistruarit e papunësuar (shih fig. nr. 8). Kërkesa për shërbime të tilla ka pësuar rënie dominante në shumicën e rajoneve gjatë 2017.

4.4 Zhvillimi i standardeve profesionale dhe kurrikulave në AAP në Republikën e Kosovës

Zhvillimi i standardeve profesionale dhe i kurrikulave në arsimin dhe aftësimin profesional (AAP) në Kosovë bazohen në Ligjin Nr. 04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional, Ligjin Nr. 04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur, Ligjin Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, dhe Ligjin Nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës. Ndërsa, dokumenti kornizë për zhvillim të standardeve të profesionit dhe kurrikulave në AAP

është Korniza Kombëtare e Kualifikimeve⁵, e zhvilluar dhe aprovuar më 2011, si dhe një sërë rregulloresh që dalin nga këto dokumente.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është institucion publik i mandatuar me Ligjin mbi Kualifikimet Kombëtare si autoriteti qendror për zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), duke përfshirë procedurat e rregullimit dhe aprovimit të standardeve profesionale dhe zhvillimit të kurrikulave të AAP në Republikën e Kosovës. Bazuar në KKK kualifikimet profesionale ofrohen përsmes mësimi formal dhe atij jo-formal (si mësim tërëjetësor)⁶.

Zhvillimi i kualifikimeve dhe kurrikulave të APP bazohen në kriteret e validimit të kurrikulave⁷, të cilat ndër të tjera përfshijnë edhe zhvillimin e kurrikulave bazuar në rezultate të të nxënit, si dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bazuar në sistemin e dhënies së kredive në AAP. Përshkrimi i rezultateve të të nxënit realizohet duke përdorur përshkuesit, varësisht se për cilin nivel të KKK zhvillohet kurrikula. Më tutje, përshkrimi i rezultateve të të nxënit bazohet në standardin respektiv të profesionit, të zhvilluar paraprakisht për atë kualifikim të AAP.

Sistemi i ofrimit të AAP në Kosovë është proces i hapur, i cili bazohet në kërkesat dhe nevojat e tregut për kualifikime profesionale. Kjo nënkupton se ofrues i kualifikimeve të AAP në Kosovë është cilido entitet legal, publik apo privat, i regjistruar në Kosovë, i cili i plotëson kushtet dhe kriteret të përcaktuara me kornizën ligjore në fuqi në raport me akreditimin institucional dhe validimin e kurrikulave arsimore. Për t'u njohur si kualifikim kombëtar, cdo ofrues i kualifikimeve të AAP është i obliguar t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional, dhe procesit të validimit të kurrikulave të cilat i ofron. Ofruesit e kualifikimeve të AAP janë të obliguar të aplikojnë pranë AKK për akreditim institucional dhe validim të kurrikulave profesionale. AKK e realizon procesin e vlerësimit përmes një grupi të jashtëm dhe të pavarur të ekspertëve të fushës, i cili proces finalizohet me vendim final të Këshillit Drejtues (KD) të AKK. Vendimi i KD të AKK bazohet në rekomandimet e raportit vlerësues të ekspertëve rreth (mos)akreditimit institucional apo validimit të kurrikulave profesionale.

Ndërsa, zhvillimi i standardeve të profesionit mbështetet me Udhëzimin Administrativ nr. 28/2014 për Kriteret dhe Procedurat për Verifikimin e Standardeve të Profesionit⁸. Poashtu, zhvillimi i

⁵ https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza_kombtare_e_kualifikimeve.pdf

⁶ Shih figurën nr. 7 për sistemin e arsimit në Kosovë

⁷ https://akkks.rks-gov.net/uploads/ua_35-2014_per_kriteret_dhe_procedurat_per_validimin_dhe_aprovimin_e_kualifikimeve_kombetare_dhe_a_kreditimin_e_institucioneve_qe_ofrojne_kualifikime_ne_kosove.pdf


⁸ [https://akkks.rks-gov.net/uploads/ua_per_kriteret_dhe_procedurat_per_verifikimin_e_standardit_te_profesionit%20\(1\).pdf](https://akkks.rks-gov.net/uploads/ua_per_kriteret_dhe_procedurat_per_verifikimin_e_standardit_te_profesionit%20(1).pdf)

standardeve të profesionit bazohet në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në UA, të cilat vlerësohen përmes angazhimit të ekspertëve të jashtëm, të cilët vijnë nga fusha relevante profesionale. Standardet e profesionit aprovohen nga Këshilli i Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe për të Rritur (KAAPRr), i cili emërohet me vendim të Ministrit të MASHT, bazuar në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Republikën e Kosovës. KAAPRr merr vendimin final për (mos)aprovim të standardeve profesionale bazuar në rekomandimet e raportit vlerësues të ekspertëve të jashtëm, të angazhuar nga AKK për këtë qëllim. Të gjitha kualifikimet e aprovuara në bëhen pjesë e Katalogut të Kualifikimeve, i cili shëbren si referencë zyrtare për profesionet në Republikën e Kosovës.

5. SHËRBIMET PUBLIKE TË PUNËSIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Niveli i punëzënies në Shqipëri duke përjashtuar vitin 2014, ka parë rritje në nivele konstante, por gjithmonë më të vogla se rritja e PPB-së.

Pas daljes nga kriza, sidomos pas vitit 2013 në shumë vende evropiane por dhe në Shqipëri dhe Kosovë u vu re i njëjti fenomen, “zhvillim pa punësim”, prandaj shumë vende e kanë quajtur këtë tendencë si sfidë të dhjetëvjeçarit të ardhshëm.




Burimi: INSTAT 2017

Figura nr.9: Rritja e PBB dhe punësimi në dhjetëvjeçarin e fundit

Bazuar në të dhënat e publikuara në Buletin Statistikor Vjetor 2017⁹, Shërbimi Kombëtar i Punësimi rezulton së në fund të 2017, janë regjistruar pranë Zyrave të Punësimi 83,497 punëkërkues të papunë nga 93,889 që ishin në fund të 2016. Me pagesë papunësie janë trajtuar 1959 persona, me ndihmë ekonomike 39292 persona dhe te tjerë 42246 persona

Figura 10. Numri i PU.PA sipas Grupeve të papunësisë



⁹ <http://www.shkp.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/BULETINI-2017->

Tregu shqiptar i punës, gjatë vitit 2017, u karakterizua nga një rënie e shkallës së papunësisë, krahasuar me një vit më parë. Shkalla e papunësisë, në 2017, për popullsinë e grup moshës 15 vjeç e lart arriti në 13,7 %, duke shënuar një ulje me 1,5 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

Të dhënat e papunësisë për dy qarqet kufitare të cilat përfshihen në projekt si Lezha dhe Kukësi paraqiten problematike sipas të dhënave të INSTAT, norma e papunësisë shënoi rritje më tej gjatë vitit të kaluar në qarkun e Lezhës. Papunësia gjatë 2017 në Lezhë pësoi rritje me 1.2 pikë përqindje. Ndërsa Kukësi ka shënuar rënie më të madhe të papunësisë me (4.3%). Sipas të dhënave të INSTAT, papunësia në Kukës ra prej nxitjes së punësimit në sektorin e shërbimeve me rreth 7 pikë përqindje.

Tabela 2 : Norma e papunësisë sipas qarqeve

	Mesa fare	Ber at	Dibër	Korçë	Durrës	Elbasan	Fier	Gjiro kastër	Ku kës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
2016	14.7	8.7	7.9	8.6	15.6	12.3	13.3	12.7	8.6	14.8	10.4	19.5	22.9
2017	13.6	11.7	6.7	7.3	11.9	8.5	13.8	13.1	13.2	16.6	12.5	17	24.6

Burimi INSTAT 2017

Tabela 3. Bilanci vjetor i papunësisë së regjistruar sipas Qarqeve

RAJONET	Gjendje në fillim	Hyrje				Dalje				Gjendje në fund	Ndryshimi ne %
		Gjithsej	Pagesa e papunësisë	Ndihma ekonomike	Grupi të tjerë	Gjithsej	Pagesa e papunësisë	Ndihma ekonomike	Grupi të tjerë		
BERAT	4022	2560	242	603	1715	3412	263	537	2612	3170	-21%
DIBER	4522	3270	182	646	2442	2983	322	550	2111	4809	6%
DURRES	8289	8228	330	481	7417	9518	399	327	8792	6999	-16%
ELBASAN	12415	5765	624	378	4763	8860	795	1344	6721	9320	-25%
FIER	10803	10691	261	708	9722	8371	329	684	7358	13123	21%
GJIROK	3465	3210	186	200	2824	3152	205	185	2762	3523	2%
KORCE	7842	4543	546	1078	2919	5932	811	1133	3988	6453	-18%
KUKES	7700	2591	403	1145	1043	3945	741	2122	1082	6346	-18%
LEZHE	5933	4423	378	1078	2967	5340	34	1313	3993	5016	-15%
SHKODER	7920	6685	519	456	5710	7550	618	868	6064	7055	-11%
TIRANE	15769	15581	1218	4069	10294	17478	1453	3975	12050	13872	-12%
VLORE	5209	5553	279	266	5008	6951	343	377	6231	3811	-27%
GJITHSEJ	93889	73100	5168	11108	56824	83492	6313	13415	63764	83497	-11%

Numri i punëkërkesve të papunë është ulur me 11%. Rajoni me uljen më të madhe rezulton Vlora me 27%.

5.1 Korniza ligjore dhe Korniza e politikave

Politikat shtetërore të punësimit në Shqipëri vendosen nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Financës dhe Ekonomisë nxit dhe realizon zbatimin e politikave për punësimin, arsimimin dhe formimin profesional nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Tregu i punës në Shqipëri rregullohet bazuar në ligjin Nr. 7995 Date 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” Qëllimi i ligjit është formimi e kualifikimin profesional, ndjekja e politikave aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plote dhe produktiv. Gjithashtu, në zbatim të ligjit gjejmë Vendimet e Këshillit të Ministrave si më poshtë:

Tabela 4. Vendimet e Këshillit të Ministrave për skemën e punësimit

Nr	Vendimet e Këshillit të Ministrave për skemën e punësimit	Përmbajtja
1.	VKM Nr.27,Për programin e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave nga grupet e veçanta ¹⁰	Përfitues të këtij programi janë gratë dhe vajzat punëkërkuese nga grupet e veçanta
2.	VKM Nr.48, Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programet e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta ¹¹	<p>Përfitues janë punëkërkuës të papunë nga grupet e veçanta si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të papunët afatgjatë; -personat, që përfitojnë ndihmë ekonomike; -personat, që përfitojnë pagesë papunësie; -personat, që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, të moshës 18-25 vjeç; -personat mbi 45 vjeç, që nuk kanë një arsimim më të lartë se arsimi i mesëm ose ekuivalent -personat me aftësi të kufizuara; -personat nga komuniteti rom; -emigrantët e kthyer, me probleme ekonomike; -viktima të trafikut.
3.	VKM NR 248,Për programimin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara ¹²	<p>Zyra përkatëse e punësimit financo për punësimin e personave me aftësi të kufizuara</p> <p>Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme</p>

¹⁰ Vendim nr.27, datë 11.1.2012 për programin e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave nga grupet e veçanta (ndryshuar me vkm nr.189, date 2.4.2014, vkm nr.459, datë 9.7.2014 dhe vkm nr. 73, datë 27.1.2016)

¹¹ Vendim .48, DATË 16.1.2008 për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta(ndryshuar me vkm nr.991, date 2.07.2008, vkm nr. 923, date 10.11.2010, vkm nr. 192, datë 2.4.2014, vkm nr.461, datë 9.7.2014 vkm 66, date 27.1.2016)

¹² V e n d i m nr. 248, datë 30.04.2014 i ndryshuar me vkm nr. 460, datë 09.07.2014 për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara

		<p>shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit</p> <p>Punëmarrësin, punëkërkuesin e papunë person me aftësi të kufizuar, sipas këtij programi, me një financim mujor në masën deri 100 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri për 6 (gjashtë) muajt e parë të punësimit;</p>
4.	VKM NR.199,Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj ¹³	Përfitues të këtij programi janë punëkërkues të rinj, të diplomuar me arsim të lartë në nivelin “Bachelor” apo “Master”, nën moshën 30 vjeç. Punëkërkuesit do të përfitojnë formim nëpërmjet punës dhe punësim, sipas fushës së diplomimit. Zyra përkatëse e punësimit financon punëdhënësin
5.	VKM Nr. 64, Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit ¹⁴	Përfitues të këtij programi janë punëkërkues të rinj, nën moshën 30 vjeç, të cilët kanë statusin e jetimit. Punëkërkuesit do të përfitojnë formim nëpërmjet punës dhe punësim. Zyra përkatëse e punësimit financon punëdhënësin:
6.	VKM Nr.47 Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë ¹⁵	Përfitues të këtij programi janë punëkërkues të papunë të cilët do të përfitojnë trajnim nëpërmjet punës. Zyra përkatëse e punësimit financon tarifën me bazë koston, në masën 19.000 lekë për çdo muaj trajnim për çdo person
7.	VKM Nr. 873,Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të	Përfshirjen në programet e praktikave profesionale në institucione/ndërmarrje, publike apo private, të punëkërkuesve të papunë, të cilët:

¹³ Vendim nr. 199, datë 11.1.2012 për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj (ndryshuar me vkm nr.188, date 2.4.2014,vkm nr. 464, datë 9.7.2014 dhe vkm nr. 67, datë 27.1.2016)

¹⁴ Vendim nr. 64, datë 27.1.2016 për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit

¹⁵ Vendim NR.47, DATË 16.1.200“për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, (ndryshuar me vkm 993, date 02.07.2008, vkm 683, datë 05.10.2011, vkm nr. 193, datë 2.4.2014, vkm 458, datë 9.7.2014 dhe vkm 65, date 27.1.2016)

	praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, Brenda apo jashtë vendit ¹⁶	a) kanë përfunduar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit; b) kanë më pak se 24 muaj, që i kanë përfunduar këto studime.
8.	VKM Nr. 162 “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional” ¹⁷	Punëkërkesit e papunë, të cilëve u është ofruar dhe kanë pranuar të marrin pjesë në një kurs të formimit profesional (kurse profesionale), mund të përfitojnë një pagesë pjesëmarrjeje në kurs, në masën 50% të së ardhurës nga papunësia, me kusht që ata të mos përfitojnë gjatë kësaj periudhe ndihmën ekonomike ose pagesën e papunësisë.

Gjithashtu qeveria Shqiptare ofron dhe programin e pagesës së papunësisë i cili mbështetet në bazën ligjore si më poshtë vijon

- ✓ VKM Nr 223, date 19.04.2006 “Për Pagesën e së Ardhurës nga Papunësia” i ndryshuar me vkm nr 194, date 9.3.2016.
- ✓ VKM Nr 192, date 9.3.2016 “Mbi caktimin e nivelit baze të së ardhurës nga papunësia”
- ✓ Udhëzim Nr 13, datë 08.04.2016 Mbi zbatimin e vkm-së nr 223, datë 19.04.2006 “Për pagesën e së Ardhurës nga Papunësia” i ndryshuar
- ✓ Rregullore Nr 826, datë 30.04.2002 “Për zbatimin e Programit të Pagesës së Papunësisë”.
- ✓ Marrëveshje “Për kryerjen e pagesave të papunësisë” midis SHKP-it dhe CREDINS Bank

Korniza e politikave publike e ndjekur nga qeveritë Shqiptare në vite ka kontribuar dhe kontribuon nëpërmjet dy rrugë për rritjen e punësimit nëpërmjet:

- Programit të modelit të zhvillimit ekonomik, sipas sektorëve prioritarë, që krijojnë vende pune në mënyrë të qëndrueshme

¹⁶ Vendim nr.873, datë 27.12.2006 i ndryshuar me vkm nr.187, datë 2.4.2014 për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit

¹⁷ Vendim nr. 162, datë 21.3.2018 Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional

- Politikave të ndërhyrjeve të drejtpërdrejta për hapjen e vendeve të reja të punës. Ky drejtim i dytë presupozon disa forma të nxitjes së punësimit:
 - i) politikat dhe incentivat për nxitjen e sipërmarrjeve private për të hapur vende të reja pune;
 - ii) programet e punëve publike komunitare, të cilat punësojnë përfitues të programeve të mbrojtjes shoqërore, si ndihma ekonomike, përfitimet për personat me aftësi të kufizuara etj;
 - iii) programet shtetërore për nxitjen e punësimit.

Politikat dhe incentivat për nxitjen e sipërmarrjeve private presupozojnë lehtësimin e detyrimeve fiskale e financiare për sipërmarrjet private, mbështetjet për krijimin e kompanive të reja, investimeve të huaja direkte etj.

Programet e punëve publike komunitare janë zbatuar në Shqipëri në fillim të vitit 2000 dhe kanë punësuar përfitues të programit të ndihmës ekonomike, persona me aftësi të kufizuara, grupe të tjera të popullsisë në nevojë etj.

Programet e nxitjes së punësimit po zbatohen aktualisht nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe përfshijnë programe për nxitjen e punësimit të grave e vajzave, nxitjen e punësimit të rinisë, të punësimit të viktimave të trafikeve të qenieve njerëzore, viktimave të dhunës, internshipe për të sapodiplomuarit etj.

Gjithashtu, kuadri i politikave aktuale të punësimit në Shqipëri mbështetet në:

- “Strategjinë Evropiane të Punësimit 2020” në aspektin metodologjik dhe stukturor, të elementëve dhe politikave të punësimit. Njëkohësisht ky kuadër politikash ka marrë parasysh faktin se Shqipëria ka disa veçori që e dallojnë atë nga vendet e BE dhe bëjnë të nevojshme përshtatje në raport me strategjinë evropiane të punësimit. Në të përfshihen:
 - a) Niveli i zhvillimit ekonomik
 - b) Struktura e popullsisë
 - c) Kufizimet e madhësisë së tregut të punës
 - d) Niveli i investimeve të huaja në rajon dhe integrimi në të i ekonomisë shqiptare.
 - e) Shkalla e arsimit
 - f) Niveli i digjitalizimit

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 ,si dhe Strategjinë Kombëtare Për punësim dhe Aftësi 2014-2020¹⁸ e cila e bazon Vizionin e punësimit në: ***“Rritjen e aftësive profesionale dhe krijimin e vendeve më të mira të punës për të gjithë burrat dhe gratë”***

Objektivat strategjikë për punësimin në Shqipëri orientohen në tre drejtime kyçe si më poshtë:

Nxitja e mundësive dinjitoze të punësimit përmes politikave më efikase të tregut të punës, nëpërmjet:

- riorganizimit të zyrave të punës në kuadrin e modelit të ri të shërbimit, me synimin e rritjes së përqindjes së pjesëmarrjes vjetore të grave/burrave në programet aktive të tregut të punës;
- përmirësimit të kuadrit ligjor dhe atij institucional në përputhje me standardet ndërkombëtare të ratifikuara, me qëllim uljen e aksidenteve në vendin e punës dhe rritjen e jetëgjatësisë së punëtorit;
- një rritjeje të numrit të grave dhe burrave që marrin pjesë në programet aktive, përmes një nxitjeje më të madhe të pjesëmarrjes dhe përmes garantimit të shumëllojshmërisë më të madhe dhe rritjes së efikasitetit të programeve.

Sigurimi i ofrimit të arsimit dhe formimit profesional cilësor (AFP) për të rinjtë dhe të rriturit nëpërmjet:

- një rritjeje të numrit të pjesëmarrësve në programet e AFP përmes optimizimit të rrjetit të ofruesve të AFP-së;
- rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të ofruesve të AFP-së përmes sigurimit të mbështetjes financiare dhe përshtatjes së inputeve dhe kapaciteteve të AFP-së (infrastruktura, ofiçinat, laboratorët, pajisjet, kurikulat, materialet didaktike, burimet njerëzore); dhe
- shtimit të lidhjeve mes studimeve dhe punës dhe lehtësimit të kalimit drejt punës nëpërmjet:

(i) rritjes së përqindjes së punësimit të nxënësve që mbarojnë arsimin profesional, nga e cila 25% duhet të jenë vajza;

¹⁸ http://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimet.pdf

(ii) rritjes së nivelit të punësimit mes pjesëmarrësve në kurse afatshkurtra të formimit profesional, dhe sidomos rritjes së përqindjes së grave;

(iii) promovimit të mëtejshëm të imazhit të arsimit dhe formimit profesional.

Ulja e mundësive për punësim informal dhe e përqindjes së punësimit informal në sektorët jo-bujqësorë nëpërmjet:

- heqjes së pengesave për ngritjen e bizneseve me qëllim uljen e informalitetit;
- zbatimit më me forcë të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese (si p.sh. inspektimet e punës);
- forcimit të bashkërendimit mes subjekteve të përfshira drejtpërdrejt apo indirekt në sektorin informal (me sektorë të tjerë si mbrojtja sociale, sigurimet shoqërore, bujqësia, financa) në nivel qendror dhe vendor;
- forcimit të legjislacionit, rregulloreve dhe politikave që kanë si pikësypnimit forcimin e mbrojtjes së punësimit, me objektiv punësimin informal (si p.sh. stimujt dhe aspektet dekurajuese);
- forcimit dhe zbatimit të kodeve dhe standardeve që respektojnë mjedisin e punës në rastet ku ka nivele të larta të informalitetit në punësim (dmth adresimi i aspekteve të shëndetit dhe sigurisë);
- organizimit të programeve pro-aktive të formimit dhe punësimit, me objektiv gratë, vajzat dhe grupe të tjera vulnerabël, si komunitetet e romëve dhe egjiptianëve;
- një pune më të mirë kërkimore, analizash dhe informacioni në lidhje me sektorin informal;
- targetimit të programeve të AFP-së për segmente prioritare të tregut informal të punës (si p.sh. komunitetet vulnerabël, profesionet me rrezik të lartë etj.); dhe
- programeve të arsimit dhe ndërgjegjësimit që përqendrohen si tek punëmarrësit, ashtu edhe tek punëdhënësit.

Politikat e punësimit në Shqipëri mbështet në disa elementë kryesorë të zhvillimit, që pasqyrohen si dhjetë arritjet e politikës së punësimit . Më konkretisht ato janë:

1. Politikat e stimulimit të kërkesës në sektorin privat, dhe politikat e stimulimit të punëzënies nëpërmjet nxitjes së ofertës. Krijimi i vlerës së shtuar në sektorin prodhues u rrit në këtë periudhe kohore me 14%, duke e rritur kërkesën në treg dhe për pasojë edhe punësimin.
2. Zhvillimi i sektorit bujqësor ishte ekstensiv por edhe intensiv, sidomos në disa produkte ku rritja e eksporteve përqendroi kapitale bujqësore dhe investime në mjete prodhimi. Zhvillimi i bujqësisë duke qenë se zinte pjesën më të madhe të forcave të punës, frenoi deri diku edhe fenomenin e migracionit të brendshëm dhe zbuti problemet sociale në fshat.
3. Përcaktimi i degëve prioritare të zhvillimit ekonomik. Kjo politikë e përdorur arriti riorganizimin strukturor të degëve kryesore, gjë që pati efekt edhe në ristrukturimin e tregut të punës. Nga ana tjetër kjo politikë garantoj një shpërndarje më të mirë rajonale të investimeve dhe krijoi premisa për reforma më të thella të pushtetit lokal.
4. Formalizimi i ekonomisë. Ndryshimet në sistemin e tatimeve sipas strukturave të biznesit jo vetëm kufizuan informalitetin në biznesin shqiptar, por kufizuan edhe mundësinë e informalitetit në tregun e punës.
5. Ndërtimi i politikave që stimulojnë rritjen e sipërmarrjeve inovative me Fonde Garancie për të gjithë ata individë ose biznese që kërkonin të zmadhoheshin dhe të nxisnin profesione të reja u pasua me rritjen e numrit të bizneseve të mesme dhe të mëdha. Kjo politikë pati si qëllim kryesor stimulimin dhe kalimin e bizneseve nga fusha e shërbimeve në fushën e prodhimit, me synimin për të mundësuar industrializimin sistematik të vendit dhe internacionalizimin e bizneseve shqiptare.
6. Modernizimi i shërbimeve të punësimit me platformë digjitale ose lufta për uljen e burokracive.
7. Zgjerimi i arsimit profesional, i cili u zgjerua si në aspektin e shkollave profesionale ashtu dhe në rritjen e nxënësve që merrnin pjesë në këto shkolla. Të dhënat nga MASR evidentojnë se vetëm në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 shkollat profesionale u rriten me 40% dhe numri i studentëve me 45%.
8. Përafrimi i legjislacionit shqiptar të punës me atë evropian, gjë që ka ndikuar si në elementë të barazisë gjinore e sociale, edhe në elementë të funksionimit të tregut të punës që fillojnë me reformën e pensioneve dhe mbarojnë me rindërtimin e strukturave të specializuara për përputhjen e kërkesës dhe ofertës.

9. Investimet në sektorin e infrastrukturës rrugore
10. Financimi i politikave të punësimit, Krijimi i Fondit për Punësim dhe Formim, Fuqizimi i rolit të Këshillit Kombëtar të Punës, Krijimi i Këshillit Kombëtar për Punësimin dhe AFP, ngritja dhe funksionimi i komiteteve sektoriale ishin hapa të rëndësishme për fuqizimin e qeverisjes së tregut të punës.

Megjithëse korniza e politikës së punësimit në Shqipëri ka treguar arritje në këtë fushë por përsëri evidentohen shumë probleme të reja të cilat kërkojnë zgjidhje, si dhe hartimin e politikave të reja ekonomike për rritjen e punëzënies, pasi punësimi është tashme prioritet dhe nevojë primare e tregut.

5.2 Masat aktive të punësimit

Politikat shtetërore të punësimit në Shqipëri përfshijnë si masat për nxitjen e punësimit ashtu dhe sigurimin e mbështetjes në të ardhura. Ne sasinë e të ardhurave përfshihen siguri i të ardhurave për papunësinë, si dhe mbështetja me të ardhura e kursanteve dhe e të papunësuarve prej një kohë të gjatë.

Për arritjen e këtyre synimeve, politikat shtetërore të punësimit zbatohen nëpërmjet zhvillimit të:

- programeve dhe projekteve aktive të tregut të punës
- formimit profesional
- riaftësimin profesional dhe formave të tjera të mbështetjes për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Shërbimet e riaftësimin profesional janë të mundshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara me kusht që ata të mund të përgatiten për to dhe të kenë perspektive për sigurimin dhe mbajtjen e punëve të përshtatshme
- sistemit të mbështetjes me të ardhura për të papunët

Ndërsa, politikat aktive të tregut të punës përfshijnë:

a. Shërbimet e Punësimit, të cilat kanë si qëllim të kryejnë informim mbi vendet e lira të punës, ndërmjetësime për punësim, këshillim dhe orientim për punë dhe profesion.

b. Programet e krijimit të vendeve të reja të punës, nëpërmjet të cilave shteti mbështet punëdhënësit që krijojnë dhe mbajnë vende të reja pune dhe punësojnë në to kandidatë të ofruar nga zyrat e punësimit, mbështetja shtetërore realizohet nëpërmjet:

- Subvencionimit, në përqindje të caktuar
- Subvencionimit apo kreditimit për pajisjen e vendit të punës.

c. Programet e formimit profesional. Formimi profesional realizohet nëpërmjet kurseve të mësimit teoriko-praktik dhe pjesëmarrjes në procese të posaçme pune. Shteti zhvillon sistemin e qendrave shtetërore të formimit profesional si dhe nxit, mbështetjes, bashkëpunimit me subjektet joshetërore të interesuara dhe punëdhënësit. Gjithashtu, Shërbimi Kombëtar i Punësimit zbaton programet shtetërore për formimin profesional dhe ofron:

- kurse pa pagesë për punëkërkuar të papunë që trajtohen nga zyrat e punësimit;
- kurse me pagesë për personat që e kërkojnë një gjë të tillë;
- mjedise dhe mjete kundrejt qirasë për subjekte që ushtrojnë formimin profesional

Institucioni i cili zbaton politikën e punësimit në Shqipëri është Shërbimi Kombëtar i Punësimit i cili financohet nga Fondi Kombëtar i Punësimit dhe është një shërbim publik autonom, me statusin e një administrate shtetërore, qendrore, që përgjigjet para ministrit të Ekonomisë dhe Financës, ndërsa Zyrat e punësimit janë pjesë integrale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, e përfaqësojnë atë dhe kanë kompetenca në nivel lokal .

Gjithashtu, pjesë e skemës së mbështetjes janë dhe programet e pagesës së papunësisë të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.

Programet e Pagesës së Papunësisë synojnë të mbështesin financiarisht të gjithë punëkërkuarët e papunë në rast papunësie për shkak të shkurtimit të vendit të punës, ndërprerjes së kontratës së punës, falimentimit të ndërmarrjes, etj. Duke lehtësuar sadopak përpjekjet e tyre drejt punësimit.

Përfitojnë të ardhura nga papunësia personat, të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Të kenë kontribuar në sigurimin shoqëror për një periudhë të paktën 12 muajore, (për çdo rast përfitimi).

b) Të jenë regjistruar si punëkërkuar të papunë pranë zyrës përkatëse të punësimit.

c) Të kenë paraqitur kërkesën me shkrim dhe të kenë plotësuar dokumentacionin përkatës, brenda 60 ditëve nga data e lindjes së të drejtës, për t'i përfituar këto të ardhura.

d) Të pranojnë të punësohen ose të kualifikohen kur u ofrohet nga zyra përkatëse e punësimit.

e) Të plotësojnë formularin e dyfishtë, i cili vihet në dispozicion nga zyra e punësimit dhe konfirmohet nga Sigurimet Shoqërore për të tre rastet e përfitimit.

- të paktën 12 muaj kontribute në sigurime shoqërore

- të paktën 5 vjet kontribute në sigurime shoqërore

- dhe mbi 10 vjet kontribute në sigurime shoqërore

Duke analizuar tërësinë e fondeve të shpenzuara për punësim deri me sot nuk ka një analizë të efektivitetit të përdorimit të tyre, aktualisht mbi bazën e vendimeve të Këshillit të Ministrave funksionojnë disa lloj fondesh për menaxhimin e papunësisë dhe nxitje të punëzënijes. Me kryesoret janë:

- Fonde për stimulimin e punëzënies me financime të drejtpërdrejta për: pjesë të pagës për punëzënie të reja, pjesë ose tërë vlerën e sigurimeve shoqërore, për fuqi punëtore që hyn për herë të parë në punë. Këtu futet dhe çdo formë tjetër e financimit me kushte të caktuara, për një grup të caktuar, për një kohë të caktuar.
- Fonde për funksionimin dhe realizimin e programeve të zyrave të punës ku futen dhe fondet e asistencës sociale apo formave të tjera të përkohshme pagese të papunësisë.
- Fonde për funksionimin e AFP ose programeve të Rikualifikimit Profesional si vazhdim i veprimtarive të krijuara dhe vlerësuara vitin paraardhës.
- Fonde për projekte me disbursim, me kusht, ku financimi realizohet pasi zbatuesi i projektit ka realizuar treguesit e ndërmjetëm apo përfundimtar të projektit.
- Fonde për zhvillimin rajonal të punësimit me bashkëfinancim në fonde publike të pushtetit lokal.
- Financimi i programeve të Riaftësimit Profesional me fonde të përbashkëta publike dhe private për pushimet masive nga puna ose gjatë ristrukturimit të shoqërive private ose gjatë privatizimit të shoqërive shtetërore.
- Fonde të tjera për programe mikse dhe financime mikse në donator të huaj.

Gjithashtu, një rol të rëndësishëm në mbështetjen e skemës së papunësisë luajnë dhe Qendrat e Formimit Profesional, të cilat bëjnë të mundur orientimin e individëve drejt kërkesës së tregut lokal të punës.

Ofrimi i trajnimit kryhet nëpërmjet një rrjeti prej dhjetë qendrash publike të formimit profesional (njëra prej tyre është qendër e lëvizshme formimi), në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë . Përveç tyre, ka edhe mbi 340 subjekte private të licencuara, 30 nga të cilat janë QFP. Ato japin certifikata që njihen nga ministria, por ende nuk ekziston një sistem monitorimi për të vlerësuar standardet e formimit që ato ofrojnë dhe cilësinë e njohurive që ato japin.

Ofruesi kryesor i kualifikimit për të rritur në Shqipëri janë ndërmarrjet nëpërmjet formimit në punë dhe kurseve të veçanta, që zgjasin nga 1 deri në 3 muaj. Ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha janë më aktive në ofrimin e trajnimit/kualifikimit dhe sasia më e madhe e formimit ofrohet në tregti, riparim makinash, në industrinë nxjerrëse, energjetike dhe përpunuese.

Qendrat e formimit profesional ofrojnë si kurse të shkurtra (4-6 javë), ashtu edhe të gjata (deri në shtatë muaj). Kryesisht këto kurse synojnë individët e papunë (të regjistruar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit ose jo), por kurset janë të hapura edhe për punëtorët dhe studentët, në varësi të nevojave të tyre për kualifikim.

Rishikimi i Ligjit të AFP-së në vitin 2011, krijoi bazën ligjore për ngritjen e Qendrave Multifunkionale të AFP-së (QMF), që do të shërbejnë si portë hyrjeje në tregun e punës dhe gjithashtu si qendra të rëndësishme që do të lidhin klientët e AFP-së (të rinjtë, studentët, të rriturit) me punëdhënësit e bizneset e mundshme, nëpërmjet stazheve dhe punës praktike në mjediset e këtyre bizneseve lokale.

Përparësia e qendrave shumëfunktionale të AFP-së krahasuar me institucionet e arsimit dhe formimit profesional është se këto qendra, për shkak të natyrës së tyre shumëfunktionale dhe gjithëpërfshirëse, veprojnë si një *one-stop shop* duke iu përgjigjur në të njëjtën kohë edhe nevojave të përfituesve të shumtë e nevojave ndërsektoriale të bashkësisë dhe tregut të punës në atë zonë.

Që nga viti 2009-2010, arsimi profesional funksionon në tre nivele duke i ofruar nxënësve formim të përgjithshëm dhe profesional (teorik dhe praktik), si dhe përgatitur për punë dhe arsimim të mëtejshëm. Programet dyvjeçare në nivelin e parë synojnë formimin e punëtorëve gjysmë të aftësuar. Nxënësit e suksesshëm marrin certifikatën bazë të formimit profesional dhe mund të hyjnë në tregun e punës, ose të vazhdojnë studimet e tyre në nivelin pasardhës.

Në nivelin e II-të, njëvjeçar, përgatiten teknikë dhe nxënësit pajisen me certifikatë të formimit profesional. Niveli i III-të, që zgjat edhe një vit mësimor, u hap rrugën nxënësve për arsimin e lartë. Në fund të këtij niveli nxënësit japin provimin e praktikës profesionale dhe atë të Maturës Shtetërore.

Arsimi dhe formimi profesional¹⁸ ofrohet në 53 shkolla (44 publike, duke përfshirë degët në shkollat e mesme të përgjithshme dhe 9 private), kryesisht të gjitha me vendndodhje në zonat urbane. Shumica e shkollave ofrojnë dy deri në katër profile, ndër to vetëm një e katërta e të gjitha shkollave ofrojnë më shumë se tetë zgjedhje profesionale. Oferta e arsimit profesional ka kaluar nga prodhimi drejt profesioneve të shërbimit (ekonomi, menaxhim, hoteleri, turizëm, TIK.

5.2 Zhvillimi i standardeve profesionale dhe kurrikulave në arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë

Republika e Shqipërisë poashtu ka një kornizë ligjore mirë të zhvilluar në raport me zhvillimin e standardeve të profesionit dhe kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional (AFP), e cila bazohet në Ligjin Nr. 15/2017 për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë¹⁹, dhe në Lin Nr.10 247 për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)²⁰.


Bazuar në Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFP) është e mandatuar për akreditimin e programeve të AFP në Republikën e Shqipërisë. AKAFP poashtu merret me zhvillimin e standardeve të profesionit, të cilat i përditëson në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale (KKKP).

Ofrues të AFP në Shqipëri mund të jenë institucione publike dhe private, të cilat akreditohen nga AKAFP. Ofruesit e AFP mund të ofrojnë kualifikime profesionale në nivelet 2-5 të KSHK, të cilat paraprakisht aplikojnë për akreditim pranë AKAFP.

¹⁹ http://www.akafp.gov.al/wp-content/uploads/2014/09/Ligji-i-ri-per-AFP_Gazeta-Zyrtare-43-2017-1-1.pdf

²⁰ <https://www.vet.al/files/ligje%20etj/LIGJ%2010247.pdf>

Figura 11 : Nivelet sipas Klasifikimit ndërkombëtar të Standardeve të Arsimit



6. KONKLUZIONET DHE PRAKTIKAT E MIRA

Politikat e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë kanë progresuar dukshëm viteve të fundit. Me gjithë ballafaqimin me sfida të vazhdueshme në zbatimin e tyre, sidomos kufizimeve buxhetore, ato vazhdojnë të jenë indikatorë kyç në dinamizimin e mundësive të punësimit, sidomos për personat me mungesë të shkathtësive për tregut të punës.

Sistemet e shërbimeve të punësimit të të dyja vendeve, kanë zhvilluar strukturat qendrore dhe lokale, duke ofruar shërbimet e punësimit tek i gjithë territori dhe qytetarët e tyre. Këto struktura ofrojnë aftësim profesional në sektorë kyç të zanateve të kërkuara në treg, si dhe ofrojnë incentiva në ndërmjetësim në punësim në modalitete të ndryshme. Megjithatë, shërbimet e tilla ofrohen vetëm për qytetarët e vendeve respektive, dhe nuk ofrohen si mundësi të rregullta ndërkufitare ndërmjet dy vendeve.

Bazuar në analizën e situatës aktuale të sistemit të punësimit në Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës evidentohen një sërë sfidash, të cilat krijojnë vështirësi në realizimin e një sistemi të qëndrueshëm veprimesh të përbashkëta nga dy vendet.

Së pari, haset vështirësi në mjedisin rregullator, i cili përfshin a) mungesën e marrëveshjeve të qëndrueshme bashkëpunimi në kohë, apo b) instutucionalizimi ligjor të formave të bashkëpunimit.

Së dyti, mungesa e infrastrukturës mbështetëse të përbashkët në ngritjen e kurrikulava apo inkubatorëve të përbashkët për kryerjen e praktikave.

Së treti, mungesa e një rrjetëzimi midis dy vendeve dhe më gjerë përbën dobësi dhe nuk ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e mobilitetit të krahut të punës.

Së katërti, shkathtësitë e dobëta të punëtorëve dhe shpeshherë në mospërputhje me vendet e punë krijojnë vështirësi në bashkimin e tregjeve.

Për këtë kërkohet përshtatje e shkathtësive të duhura, për të promovuar krijimin e vendeve të punës, e cila do të ndihmojnë në zvogëlimin e hendekut të papunësisë në të dy vendet

Për më shumë, raporti analizon dhe praktikat pozitive si në rastin e dy marrëveshjeve të vitit 2015, të nënshkruara midis Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë. Të dy vendet arritën marrëveshjen e parë në drejtim të inicimit të bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në rajonet rreth kufirit të të dyja vendeve. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) të Republikës së Kosovës, dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe

Rinisë (MMSR) të Republikës së Shqipërisë, thekson vullnetin e të dyja vendeve rreth eksplorimit të praktikave të ofrimit të shërbimeve të punësimit për qytetarët e vendeve respektive në aftësim profesional, si dhe në mobilitet punësimi.

Rajonet pranë kufitare të favorizuara me marrëveshje janë ato të Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës nga Republika e Kosovës, dhe ato të Kukësit, Hasit dhe Tropojës nga Republika e Shqipërisë.

Edhe pse marrëveshja i ka pothuaj katër vite jetëgjatësi, vendet deri tani kanë ndërmarrë hapa të kufizuar në raport me shfrytëzimin e dispozitave të marrëveshjes për fuqizim të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Në anën tjetër është potencial i madh i mundësive të shfrytëzimit të masave aktive të punësimit nga qytetarët përtej kufijve, sidomos në sektorë të rinjë të ekonomisë, sikurse janë mbledhja, kultivimi dhe procesimi i frutave të malit dhe bimëve mjekësore, potencialit të eko-turizmit dhe turizmit malor, si dhe sektorë tjerë të zhvillimit të rajoneve pranë kufitare.

7. REKOMANDIMET

Duke parë mundësitë për të avancuar politikat e punësimit dhe rritur incentivat për punësim të të papunëve, duhet më tutje të eksplorohet dhe shfrytëzohet potenciali për hapa të përbashkëta ndërmjet dy vendeve për të përkrahur mobilitetin e fuqisë punëtore, posaçërisht në zonat pranë kufitare. Me këtë rast, janë identifikuar dhe definuar disa masa që do mund të kthehen në iniciativa konkrete, të cilat në vijim janë formuluar në formë të rekomandimeve.

Gjithashtu, si pjese e rekomandimeve në funksion të masave sugjerohet dhe një Plan Veprimi konkret me qëllim rritjen e mobilitetit dhe punësimin e banorëve të zonave kufitare Shqipëri-Kosovë.

Masa / rekomandimi	Bartësit e procesit	Hapat në vijim
Rikonceptimi dhe vazhdimi i marrëveshjes ndërqeveritare, duke theksuar definimin e një plani konkret veprimi me përgjegjësi dhe afate nga të dyja vendet.	MPMS, MFE, APRK, ShKP	<ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i marrëveshjes së re - Nënshkrimi i marrëveshjes
Adaptimi i legjislacionit në mundësimin e zbatimit të masave të punësimit përtej kufirit.	MPMS, MFE, APRK, ShKP	<ul style="list-style-type: none"> - Analizimi i kornizës aktuale ligjore të të dyja vendeve, dhe definimi i hapave konkretë për vendosje të dispozitave të reja ligjore. - Hartimi i dispozitave të reja ligjore, së paku në nivel të udhëzimit administrativ (legjislacionit sekondar), dhe miratimi tyre.
Zhvillimi i planit të veprimit, me masa konkrete aktive, indikatorë të rezultateve, sektorë të punësimit, dhe	APRK, ShKP	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi i një grupi të përbashkët punues. - Draftimi i Planit të Veprimit

indikatorë buxhetorë për të mbështetur zbatimin e planit.		- Miratimi i Planit të Veprimit nga autoritetet respektive të të dyja vendeve.
Alokimi buxhetor vjetor për të mbështetur zbatimin e planit të veprimit.	APRK, ShKP	Planifikimi dhe alokimi vjetor i buxhetit në kornizat e rregullta buxhetore.
Vendosja e kornizës së qëndrueshmërisë së masave të pajtuara në periudhë afatgjatë të veprimit.	APRK, ShKP	- Formimi i një ekipi për koordinim, dhe monitorim të zbatimit të masave të vendosura. - Takime në baza të rregullta të ekipit të caktuar në krijim të qëndrueshmërisë së bashkëpunimit.

Rezultatet e pritura:

- Reduktim i papunësisë afatgjatë për rajonin e Kukësit dhe Prizrenit për femrat dhe meshkujt
- Reduktim i papunësisë rinore për të rejtat dhe të rinjtë
- Rritja me 100% e mobilitetit të krahut të punës në rajonin e Kukësit dhe Prizrenit
- Rritja me 30% të pjesëmarrësve në programe të nxitje së punësimit
- Rritja me 50% e kurseve specifike për trajnimin profesional të grave dhe të kategorive në nevojë nga rajonet kufitare Shqipëri – Kosovë

8. BIBLIOGRAFIA

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2016). Ligjin nr.5 /L-077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të papunët, Punëkërkuessit dhe Punëdhënësit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 12 / 15 maj 2012, Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2014). Ligjit nr. 04 / L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare Republikës së Kosovës / Nr. 1 / 09janar 2014, Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2012). Ligjin nr. 04 / L-083 për Regjistrimin dhe Evidencën e Papunësuarve dhe Punëkërkuessve. Gazeta Zyrtare Republikës së Kosovës / Nr. 12 / 15 maj 2012, Prishtinë.

MPMS (2018). Rregullorja (nr. 01 / 2018) për Masat Aktive të Tregut të Punës.

MPMS (2018). Strategjia Sektorial 2018-2022.

MPMS (2016). Puna dhe Punësimi.

MPMS (2015). Puna dhe Punësimi.

MPMS (2014). Puna dhe Punësimi.

MPMS (2013). Puna dhe Punësimi.

Projekti SWEI-Fuqi Punëtore e Shkathët për Integrim Ekonomik (Skilled Workforce for Economic Integration) është projekt i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë i financuar nga Bashkimi Evropian, i cili implementohet nga APPK-Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë dhe ISI- Instituti për Studime Ndërkombëtare në Shqipëri.



AGJENSIONI I PËRKRAHJES SË PUNËSIMIT KOSOVË
BESCHÄFTIGUNGSFÖRDERUNG AGENTUR KOSOVO
EMPLOYMENT PROMOTION AGENCY KOSOVO

